



Titulli i projektit

Sistemim hapësire të gjelbëruar përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës

Tipi i projektit

Shërbimet publike/Sektori strategjik i turizmit/
Sektori i shërbimeve

Vendndodhja e projektit

Vija bregore e Liqenit të Shkodrës në ZF Malësi e Madhe
NJQV Qendër, Kastrat, Koplik, Guremirë

Buxheti i paravlerësuar

50,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Liqeni i Shkodrës është pjesë kyçe e potencialit të të ardhurave nga turizmi liqenor i pjesës fushore të zonës funksionale Malësi e Madhe. Në analizën e Programit të Zonës Funksionale nënvijëzohet statusi i zonës së mbrojtur që ka aktualisht liqeni dhe nevoja për rehabilitimin e florës dhe faunës së tij, si një pikënisje e nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në këtë zonë në të ardhmen. Në këto kushte, sistemimi dhe gjelbërimi i bregut të liqenit, me bazë bimësinë që karakterizon pellgun, është një hap fillestar, i cili duhet të ndiqet nga format të tjera të rigjallërimit të qëndrueshëm të jetës së liqenit.

Qëllimi/et specifik të projektit

Projekti synon tërheqjen e vizitorëve në zonën e Malësisë së Madhe dhe shtimin e njëjës tregtare, restoranteve dhe shërbimeve në përgjithësi, me anë të rigjallërimit të florës së liqenit të Shkodrës.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë rritja e numrit të vizitorëve në zonën përreth bregut të liqenit, si dhe shtimi apo zgjerimi i shërbimeve tregtare, restoranteve, etj.. Drejtpërdrejt, ndikohen fshatrat e vijës bregore të liqenit nëpërmjet bizneseve me natyrë turistike, apo të shërbimeve. Njësitë vendore përkatëse përbëjnë gjithsej 77 % të popullsisë së zonës funksionale (rreth 42000 banorë).

PROJEKTI 12



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Ndër punimet bazë, të cilat mund të parashikohen në këtë projekt, janë:

1. Pastrimi dhe sistemimi i bregut të liqenit të Shkodrës;
2. Sistemimi i truallit dhe gjelbërimi i tij;
3. Mbjellja e bregut me bimësi karakteristike.

Maturimi i projektit

Projekti është një ide në mbështetje të konceptit të zhvillimit strategjik të Malësisë së Madhe hartuar në analizën e Programit të Zonës Funksionale. Nga ana tjetër, ka një studim mbi Liqenin e Shkodrës: "Plani Strategjik i Veprimit për Liqenin e Shkodrës në Shqipëri dhe Malin e Zi", i cili është hartuar nga ministrinë përgjegjëse të mjedisit të të dy vendeve. Ky dokument përshkruan gjendjen e florës karakteristike të pellgut dhe nevojat për ndërhyrje, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemit.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Donatorë të mundshëm të projektit janë identifikuar: Ministria e Mjedisit, buxheti i qeverisë vendore, Fondi Global i Mjedisit, Banka Botërore, si dhe fondet IPA.

Kostot e projektit

Kostoja e përafërt e sistemimit të një territori të gjelbërt dhe pasija me vende qëndrimi prej druri ose materialesh në përputhje me natyrën është 50,000 Euro.